

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“AM CONSTRUCTION” SH.P.K.

Sot në Tiranë, më datën 26.01.2024, me cilësinë e ortakut themelues të shoqërisë:

AMBRA MUÇA e bija e **LUAN MUÇA** lindur më 25.10.1993 në Elbasan dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal J36025065B me cilësinë e Ortakut themelues, hartojmë këtë akt themelimi të Shoqërisë Tregtare “**AM CONSTRUCTION**” **SH.P.K.**

Me nënshkrimin e këtij Akti Themelimi të shoqërisë tregtare, nënshkruesi dhe themeluesi i saj merr përsipër të realizojnë e të respektojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga klauzolat e mëposhtme, të cilat do të specifikohen gjerësisht në Statutin e shoqërisë:

THEMELIMI I SHOQËRISË

Në mbështetje dhe zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar si dhe ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit", i ndryshuar themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “**AM CONSTRUCTION**” **sh.p.k.** (më poshtë në këtë akt e quajtur "Shoqëria") nga Ortaku themelues i saj.



FORMA E SHOQËRISË

Shoqëria “AM CONSTRUCTION” SH.P.K. më poshtë e referuar si “Shoqëria”, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar krijuar në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, dhe rregullohet prej këtij ligji, dhe statutit të shoqërisë si dhe prej cdo dispozite tjetër ligjore të aplikueshme.

II. EMRI I SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

NENI 1

EMRI

Emri i shoqërisë është “AM CONSTRUCTION” SH.P.K. Në cdo dokument, faturë, reklamë dhe publikime emri i shoqërisë do të pasohet nga:

- (i) fjala “me përgjegjësi të kufizuar” apo “sh.p.k”
- (ii) numri i saj i regjistrimit
- (iii) selia

NENI 2

SELIA

Selia administrative e shoqërisë do të jetë në Autostradën Tr-Dr, km 1.5, godina Delta Sha, Mezez, Tiranë

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është për një periudhë kohe të pacaktuar, duke filluar prej momentit të regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



2

III OBJEKTI I SHOQËRISË

NENI 4

OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar do të jetë:

1. Kompani ndërtimi

Përvec veprimtarisë së parashikuara më lart, në veprimtarinë e shoqërisë do të hyjë cdo veprimtari që do të konsiderohet nga Asambleja e Ortakëve si e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektit të shoqërisë dhe që nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin Shqiptar.

IV KAPITALI THEMELTAR DHE ORGANIZIMI

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është përcaktuar në shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë dhe kuota e pjesmarrjes është 100%.

NENI 6

ORGANIZIMI

Shoqëria do të drejtohet nga një Administrator. Këtë detyrë do ta kryej për një periudhë prej 5(pesë) vitesh, **Znj.AMBRA MUÇA**, e cila do të ushtrojë të gjitha kompetencat për administrimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë, për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ose Statuti ia jep shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme.

ORTAKU

“AM CONSTRUCTION” SH.P.K

AMBRA MUÇA

Ambra Muça
3
Muça